



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

PËR/TO/ZA:	Kryetarin e Komunës z. Shpejtim Bulliqi
NGA/FROM/OD:	Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik Pajtim Balaj
CC:	Kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Fatmir Gashi
TEMA/SUBJECT:	Raporti i Diskutimit Publik i Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale me nr. prot. 01-431-04-0014941/18 i datës 14 qershor 2021
REFERENC/E:	Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. prot.01-070/05-0045287/21 i datës 04 qershor 2021
DATE/A:	13 korrik 2021

Të nderuar/a

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2021, me vendimin e lartcekur nën referencë, e ka vënë në diskutim publik Rregullorën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale me nr. prot.01-431-04-0014941/18, të datës 14 qershor 2021.

Afati kohor i diskutimit publik ka qenë nga data 7 qershor deri më datën 07 korrik 2021. Në zbatim të vendimit të Kuvendit të Komunës, ne si Drejtori bashkë me Zyrën për Mardhënie me Publikun kemi ndërmarrë veprimet, që t'u mundësojmë bizneseve dhe shoqërisë civile të japin vërejtjet, propozimet apo rekomandimet në dokumentin e lartcekur.

Duke qenë se objekt i ndryshimit të rregullores është neni 6, ku ne kemi propozuar lirimin nga taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste të subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës, ka ndikuar që të mos ketë interesim për dëgjimin publik, për faktin se ky veprim e lehtëson veprimtarinë afariste dhe ngase në këtë drejtim nuk kanë passur kundërshti apo mospajtim, prandaj duket të ketë pajtueshmëri të përgjithshme. Në takimin e paraparë më datë 14 qershor 2021, nuk ka patcipuar asnjë palë e interesit, ndërsa në adresën elektronike nuk kemi pasur asnjë propozim, vrejteje apo rekomandim.

Nga sa u tha më lartë ne i rekomandojmë Kuvendit të Komunës ta miratoj Rregulloren për ndryshim dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale në formën e propozuar!